



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

Nr. 100 Prot.

Tiranë, më dt. 18.04.2018

VENDIM

Nr.177, dt. 18.04.2018

Në mbështetje të nenit 17, pika 3, të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore", i ndryshuar, bazuar dhe në rregulloren e miratuar me vendim KKR nr. 58, date 10.01.2018 "Mbi kriteret dhe procedurat administrative për marrjen e licensave të ushtrimit të profesionit të restauratorit", në mbledhjen e dt. 18.04.2018 Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, pasi shqyrtoi kërkesën për heqje të licencës së Restaurimit të dhënë shoqërisë "SCAI" sh.p.k për shkak të paraqitjes së dorëheqjes së drejtuesit Teknik Ark. Jorgo Xuhano nga kjo shoqëri si dhe të shqyrtimit të kërkesës për dhënie license në fushën e restaurimit për Shoqërinë "N.T.P. Eurokos dega në Shqipëri" shpk, me drejtues teknik Ark. Rest. Jorgo Xuhano (R.P. 11),

VENDOSI:

1. Të miratojë kërkesën për heqjen e licencës së shoqërisë "SCAI" sh.p.k për shkak të mbetjes pa drejtues teknik restaurator.
2. Të miratojë kërkesën e Shoqërisë "N.T.P. Eurokos dega në Shqipëri" shpk me drejtues ligjor Z. Ismet Rexhaj për pajisje me licensë restaurimi për kategorinë:
"C.Z. Zbatim për punimet e restaurimit në monumentet e arkitekturës për shoqëri ndërtimi me drejtues teknik Ark. Jorgo Xuhano (R.P 11).
3. T'i propozojë Ministrit të Kulturës, miratimin e kërkesës për pajisje me licensë restaurimi për Shoqërinë "N.T.P. Eurokos dega në Shqipëri" shpk, për kategoritë:
"C.Z. Zbatim për punimet e restaurimit në monumentet e arkitekturës për shoqëri ndërtimi me drejtues teknik Ark. Jorgo Xuhano (R.P 11).
4. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI KKR

Arta Dollani

KRYETAR
Mirëla Kumbaro Furxhi

